



Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione për OJQ të cilat operojnë në territorin e komunës së Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

### THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONIM TË SPORTIT

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës, që veprojnë në komunën e Rahovecit, të aplikojnë për mbështetje financiare nga subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport.

#### Qëllimi:

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është mbështetja financiare për klubet e sportit, OJQ-të dhe sportistët individual, që aktivitetin dhe fushëveprimtarinë kryesore e kanë sportin dhe projektet që ndërlidhen me vetëdijesimin dhe përfshirjen e të rinjve të komunës së Rahovecit në aktivitete sportive.

#### Specifikat e thirrjes publike:

- Thirrja publike për aplikim hapet më: 19.02.2021 dhe mbyllet më 11.03.2021, në orën 16:00.
- Aplikacionet e dërguara pas mbylljes së afatit nuk do të pranohen;
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen;
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DKRS;
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i subvencionit (OJQ) do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

#### Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit:

- Projekt-propozimi, përfshirë agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit;
- Formulari i aplikacionit;
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar;
- Certifikata me numër të regjistrimit të OJQ-së dhe me numër fiskal;
- Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- Kopja e kartelës së xhirollogarisë dhe konfirmimi bankar i xhirollogarisë së aplikuesit;
- Raporti financiar i vitit paraprak 2020.

#### Mënyra e aplikimit:

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen 2 kopje e gjithë dokumentacionit origjinal,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në objektin e Komunës sporteli nr. 7,
- Formulari i aplikimit dhe formulari financiar mund të shkarkohet në faqen e Komunës:  
<https://kk.rks-gov.net/rahovec/>

Rahovec, më: 19.02.2021

Bjondina Kleqka

Drejtoreshë

